



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 1, datë 22.01.2020**

**PËR**

**DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN NR. 127, DATË 06.10.2011 “PËR  
PËRMBAJTJEN E DETYRUESHME, AFATET DHE FORMËN E RAPORTEVE TË  
SIPËRMARRJEVE TË INVESTIMEVE KOLEKTIVE, SHOQËRIVE TË  
ADMINISTRIMIT DHE DEPOZITARËVE”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 2 të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e disa ndryshimeve në Rregulloren nr. 127, datë 06.10.2011 “Për përmbajtjen e detyrueshme, afatet dhe formën e raporteve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, shoqërive të administrimit dhe depozitarëve”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve, për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**  
**Ervin METE**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**  
**Ervin KOÇI**

**Në Rregulloren nr. 127, datë 06.10.2011 “Për përmbajtjen e detyrueshme, afatet dhe formën e raporteve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, shoqërive të administrimit dhe depozitarëve”, e ndryshuar, bëhen ndryshimet si më poshtë:**

**1. Në nenin 3, bëhen këto ndryshime:**

- a. Fshihen shkronjat i) dhe ii), të shkronjës a), paragrafi 1, pasi ky informacion publikohet në pikat vijuese të rregullores. Përkatësisht shkronja i) publikohet në shkronjën iii) të të njëjtës pikë dhe shkronja ii) publikohet në shkronjën i) të pikës c) të paragrafit 1;
- b. Fshihet pika b) e paragrafit 1, pasi ky informacion do të jetë raport që do të llogaritet automatikisht nga sistemi dhe nuk ka detyrim raportimi për shoqëritë administruese;
- c. Në pikën c) të paragrafit 1 shtohet shkronja iv) “Raport mbi investimet e sipërmarrjes së investimeve kolektive”, i cili është informacion që aktualisht i kërkohet bankave depozitare me e-mail dhe do të raportohet nëpërmjet sistemit.

**2. Në nenin 4, bëhen këto ndryshime:**

- a. Në paragrafin 1, rreshti 4, pas tog fjalëve “dhe do të dërgohet tek Autoriteti” do të shtohet “në formë elektronike nëpërmjet sistemit pranë linkut vënë në dispozicion në faqen e Autoritetit për këtë qëllim”. Të dhënat ditore të muajit paraardhës do të dërgohen në Autoritet në formë shkresore brenda 3 ditë pune të muajit pasardhës;
- b. Në paragrafin 3, rreshti 1, pas tog fjalëve “të referuara në nenin 3, paragrafi 1, pika (c)” do të shtohet “shkronja ii) dhe iii)” për të saktësuar referencën e përmendur;
- c. Shtohet pika 4: “Raportet mbi investimet e sipërmarrjes së investimeve kolektive duhet të raportohen nga depozitari në Autoritet, nëpërmjet sistemit pranë linkut vënë në dispozicion në faqen e Autoritetit për këtë qëllim, brenda afateve të përcaktuara për raportimin e pasqyrave financiare nga ana e shoqërive administruese, të referuara në nenin 10, paragrafi 2 dhe 3 të kësaj rregulloreje.”

**3. Në nenin 11, bëhen këto ndryshime:**

Në paragrafin 1, rreshti 2, ndryshon mënyra e raportimit nga formatet excel dhe pdf në formën nëpërmjet sistemit dhe fjalia bëhet: “Pasqyrat financiare duhet të paraqiten në formë shkresore pranë Autoritetit si dhe në formë elektronike nëpërmjet sistemit pranë linkut vënë në dispozicion në faqen e Autoritetit për këtë qëllim brenda afateve të referuara në nenin 10, paragrafi 2 dhe 3 të kësaj rregulloreje”.

**4. Në nenin 17, bëhen këto ndryshime:**

Në paragrafin 1, rreshti 2 ndryshon mënyra e raportimit nga formatet excel dhe pdf në formën nëpërmjet sistemit dhe fjalia bëhet: “Pasqyrat financiare duhet të paraqiten në formë shkresore pranë Autoritetit si dhe në formë elektronike nëpërmjet sistemit pranë linkut vënë në dispozicion në faqen e Autoritetit për këtë qëllim brenda afateve të referuara në paragrafët 2 dhe 3 të nenit 16 të kësaj rregulloreje.”

**5. Në nenin 26, bëhen këto ndryshime:**

- a. Titulli i nenit pas fjalës “Afatet” shtohet tog fjalësh “dhe forma”;
- b. Paragrafi 2, rreshti 4, pas tog fjalësh “të pikës 1 si edhe në pikën 3 të nenit 25 të kësaj rregulloreje” do të shtohet “në formë shkresore dhe nëpërmjet sistemit pranë linkut vënë në dispozicion në faqen e Autoritetit për këtë qëllim”;
- c. Paragrafi 3, rreshti i fundit, pas tog fjalësh “informacioni i përcaktuar në pikën 2, të nenit 25 të kësaj rregulloreje” do të shtohet “në formë shkresore dhe nëpërmjet sistemit pranë linkut vënë në dispozicion në faqen e Autoritetit për këtë qëllim”.

**6. Në nenin 26/2, bëhen këto ndryshime:**

- a. Titulli i nenit pas fjalës “Afatet” shtohet tog fjalësh “dhe forma”;
- b. Paragrafi 1, rreshti 3, pas tog fjalësh “përcaktuar në pikën 1 të nenit 26/1 të kësaj rregulloreje” do të shtohet “në formë shkresore dhe nëpërmjet sistemit pranë linkut vënë në dispozicion në faqen e Autoritetit për këtë qëllim”;
- c. Është shtuar neni 28 “Dispozita kalimtare” me teksti si vijon: Për periudhat financiare deri në 31.12.2020, shoqëritë administruese përveç formave të raportimit të përmendura në këtë rregullore do të vazhdojnë të raportojnë dhe në formatin excel me email pranë departamentit përkatës të gjithë raportet e përfshira në shtojcat 1, 2, 4, 5, 6 dhe 7.

**7. Në Shtojcën 1, “Raporte mbi aktivitetin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive”, bëhen këto ndryshime:**

Fshihet pika 1, “Raport në lidhje me vlerësimin e asetëve dhe llogaritjen e vlerës neto për kuotë/aksion”, pasi ky informacion dublikohet në pikën 3 të kësaj shtojce.

**8. Fshihet Shtojca 2 “Raportet mbi aktivitetin e shoqërive administruese”, pasi ky informacion do të jetë pjesë e pasqyrave të raportimit financiar të shoqëritë administruese.**

**9. Në Shtojcën 3, “Raportet mbi aktivitetin e depozitarit”, bëhen këto ndryshime:**

- a. Pika 1, Raport mbi asetet e sipërmarrjes së investimeve kolektive për të cilën depozitari kryen shërbimet e depozitarit, zëvendësohet tabela me tabelën e cila në përputhje me rregulloren 77, datë 29.06.2011 “Mbi përcaktimin e vlerës së asetëve të sipërmarrjeve të investimit kolektiv dhe llogaritjen e vlerës neto të asetëve të tyre për kuotë ose për aksion”, do të raportohet në bazë ditore nëpërmjet sistemit si më poshtë:

| Data | Vlera neto e aseteve të fondit | Numri i kuotave të fondit | Çmimi i kuotës i fondit |
|------|--------------------------------|---------------------------|-------------------------|
|      |                                |                           |                         |

- b. Shtohet pika 4, “Raport mbi investimet e sipërmarrjes së investimeve kolektive”, me tabelat e më poshtme:

| Lloji   | ISIN | Vlera Nominale | Vlera Kontabël | Monedha |
|---------|------|----------------|----------------|---------|
| Aksione |      |                |                |         |
|         |      |                |                |         |
| Fonde   |      |                |                |         |
|         |      |                |                |         |
|         |      |                |                |         |

| Lloji                           | ISIN | Vlera Nominale | Vlera Kontabël | Monedha | Data e maturimit |
|---------------------------------|------|----------------|----------------|---------|------------------|
| Bono Thesari                    |      |                |                |         |                  |
|                                 |      |                |                |         |                  |
| Obligacione Qeveritare të Huaja |      |                |                |         |                  |
|                                 |      |                |                |         |                  |
| Obligacione Qeveritare Vendase  |      |                |                |         |                  |
|                                 |      |                |                |         |                  |
| Obligacione të Shoqërive        |      |                |                |         |                  |
|                                 |      |                |                |         |                  |

**10. Në shtojcën 4, “Pasqyrat financiare të shoqërisë së administrimit”, bëhen këto ndryshime:**

Në pasqyrën e bilancit aktivi shtohen dy zëra dhe bëhet si më poshtë:

| AKTIVI                         | Lekë                    | Lekë                   |
|--------------------------------|-------------------------|------------------------|
|                                | Data e vitit paraardhës | Data e vitit ushtrimor |
| A. Aktive afatgjata (I+II+III) |                         |                        |

|  |  |  |
|--|--|--|
| I. Aktive të paqëndrueshme                                   |  |  |
| II. Aktive të qëndrueshme                                    |  |  |
| III. Aktive financiare (1+2)                                 |  |  |
| 1. Depozita bankare  |  |  |
| 2. Aktive të tjera dhe debitorë afatgjatë                    |  |  |
| B. Aktive afatshkurtra (I+II+III+IV)                         |  |  |
| I. Pajisje në magazinë, inventar i imët dhe pajisje të tjera |  |  |
| II. Debitorë(1+2+3+4)  |  |  |
| 1. Debitorë nga sipërmarrjet kolektive                       |  |  |
| 2. Debitorë nga sasi të e paguara tepër prej fitimit         |  |  |
| 3. Debitorë nga shteti dhe institucione të tjera             |  |  |
| 4. Debitor të tjerë  |  |  |
| III. Aktive financiare (1+2+3+4)                             |  |  |
| 1. Depozita bankare  |  |  |
| 2. Aktive të tjera dhe debitorë afatshkurtër                 |  |  |
| 3. Kuota në fonde investimi                                  |  |  |
| 4. Të tjera aktive financiare                                |  |  |
| IV. Mjete monetare në bankë dhe arkë (1+2)                   |  |  |
| 1. Mjete monetare në bankë                                   |  |  |
| 2. Mjete monetare në arkë                                    |  |  |
| C. Shpenzime të parapaguara                                  |  |  |
| D. Të ardhura të marra në avancë                             |  |  |
| E. Aktive (A+B+C+D)  |  |  |
| F. Zëra jashtë bilancit                                      |  |  |
| TOTAL (E+F)  |  |  |

a. Pas pasqyrës së fitim humbjes shtohet pasqyra “Detajim Tarifash” si më poshtë:

| Emërtimi i Fondit | Lloji i Fondit | Tarifa e Administrimit |
|-------------------|----------------|------------------------|
|                   |                |                        |
|                   |                |                        |
|                   |                |                        |
|                   |                |                        |
|                   |                |                        |

- b. Pas pasqyrës së ndryshimit të kapitalit shtohet pasqyra “Raporti i kapitalit” si më poshtë:

| Emërtimi                      | Vlera                                 |
|-------------------------------|---------------------------------------|
| Kapitali fillestar            | 15,625,000                            |
| Më pak ose i barabartë me     | 31,250,000,000                        |
| Asete nën administrim         |                                       |
| Diferenca                     | (llogaritet automatikisht me formulë) |
| Rritja me 0.02% të tejkalimit | (llogaritet automatikisht me formulë) |
| Kërkesa ligjore e kapitalit   | (llogaritet automatikisht me formulë) |

Shtohen tabelat e strukturës së investimeve si më poshtë:

*Pasqyra e strukturës së investimeve*

Mjete monetare dhe ekuivalentë

| Pozicioni                            | Referenca | Maturiteti | Vlera në momentin e depozitimit | Vlera në datën e raportimit |
|--------------------------------------|-----------|------------|---------------------------------|-----------------------------|
| Depozita nën 3 muaj                  |           |            |                                 |                             |
| Llogari rrjedhëse                    |           |            |                                 |                             |
| <b>TOTALI MJETEVE DHE DEPOZITAVE</b> |           |            |                                 |                             |

Depozita

| Pozicioni                            | Referenca | Maturiteti | Vlera në momentin e depozitimit | Vlera në datën e raportimit |
|--------------------------------------|-----------|------------|---------------------------------|-----------------------------|
| Depozita mbi 3 muaj                  |           |            |                                 |                             |
| <b>TOTALI MJETEVE DHE DEPOZITAVE</b> |           |            |                                 |                             |

Obligacionet

| Pozicioni                       | ISIN | Qëllimi i mbajtjes | Shteti | Maturiteti | Vlera nominale | Vlera e blerjes | Vlera në datën e raportimit |
|---------------------------------|------|--------------------|--------|------------|----------------|-----------------|-----------------------------|
| Obligacione të Qeverisë vendase |      |                    |        |            |                |                 |                             |

|   |  |  |  |  |  |  |  |
|---|--|--|--|--|--|--|--|
| Obligacione bashkiake vendase             |  |  |  |  |  |  |  |
| Obligacione të Qeverive të huaja          |  |  |  |  |  |  |  |
| <b>TOTALI I OBLIGACIONEVE TË QEVERIVE</b> |  |  |  |  |  |  |  |

| Pozicioni                                  | ISIN | Qëllimi i mbajtjes | Shoqëria | Maturiteti | Vlera nominale | Vlera e blerjes | Vlera në datën e raportimit |
|--|------|--------------------|----------|------------|----------------|-----------------|-----------------------------|
| Obligacione Shoqërisht Vendase             |      |                    |          |            |                |                 |                             |
| Obligacione Shoqërisht të huaja            |      |                    |          |            |                |                 |                             |
| <b>TOTALI I OBLIGACIONEVE TË SHOQËRIVE</b> |      |                    |          |            |                |                 |                             |

*Pasqyra e strukturës së investimeve*

Letra me vlerë të tjera

| Pozicioni   | ISIN | Maturiteti | Vlera nominale | Vlera e blerjes | Vlera në datën e raportimit |
|---|------|------------|----------------|-----------------|-----------------------------|
| Bono të thesarit vendase                                      | -    | -          | -              |                 |                             |
| Emetime të bankës qendrore vendase                            |      |            |                |                 |                             |
| Dëftesa tregtare vendase                                      |      |            |                |                 |                             |
| Kuota në fonde vendase  |      |            |                |                 |                             |
| Letra të tjera me vlerë vendase                               | -    | -          | -              |                 |                             |
| <b>TOTALI I LETRAVE TË TJERA ME VLERË TË EMETUESVE VENDAS</b> | -    | -          | -              |                 |                             |
| Bono të thesarit të huaja                                     |      |            |                |                 |                             |

|   |  |  |  |  |  |
|---|--|--|--|--|--|
| Emetime të bankës qendrore të huaja                         |  |  |  |  |  |
| Dëftesa tregtare të huaja                                   |  |  |  |  |  |
| <b>TOTALI I LETRAVE TË TJERA ME VLERË TË EMETUESVE HUAJ</b> |  |  |  |  |  |

**11. Në shtojcën 5, “Pasqyra financiare të fondeve të investimit”, bëhen këto ndryshime:**

- a. Përmirësime në përshkrimin e zërave në pasqyrën e pozicionit financiar dhe në pasqyrën Fitim/Humbje në kuadër të implementimit të IFRS9 nga ana e fondeve të investimit;
- b. Pas pasqyrës së ndryshimeve në asetet neto shtohet pasqyra “Ndryshimi në kuotat e fondit” si më poshtë”:

|  | Numri i kuotave të fondit | Aktivet e fondit (Lekë) | Aktive për kuotë (Lekë) |
|--|---------------------------|-------------------------|-------------------------|
| Lloji                                    |                           |                         |                         |
| Në fillim të periudhës                   |                           |                         |                         |
| Emetuar gjatë periudhës                  |                           |                         |                         |
| Tërhequr për shkak të largimit nga fondi |                           |                         |                         |
| Në fund të periudhës                     |                           |                         |                         |